



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAVAJË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / 2020

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Bashkimin e operatorëve ekonomike **G.P.G Company shpk** dhe **Shëndelli shpk**

Adresa: Fier Lushnje Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut.

Procedura e prokurimit: E Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-51835-02-27-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

1. Fondi limit: **659,510,733** (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) **lekë pa tvsh**.
2. Burimi i Financimit: **GRANTI**
3. Objekti i kontratës: "**Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës për furnizimin me ujë të qytetit Kavajë dhe ndërtimi i depo uji të re, faza e dytë**".

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët** ●; oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE G.P.G Company shpk me Nipt J64324443V dhe Shëndelli shpk me Nipt K07924803N, vlera **658,284,768** (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë milion e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh
2. B93 II shpk, Nipt-i L522090500 vlera **659,115,596** (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh
3. Alb-Star shpk, Nipt-i K37209201G vlera **659,384,824** (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e njëzet e katër) lekë pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. B93 II shpk
2. Alb-Star shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik Alb-Star shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte këto kriteret:

- Nuk janë paraqitur kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2016, 2017, 2018), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me akt ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar., siç përcaktohet në pikën 2.2.1 të “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të DST
- Nuk është paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, siç përcaktohet në pikën 2.2.3 të “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të DST
- Nuk është paraqitur asnjë dokument për të provuar përvojën e meparshme të operatorit ekonomik, siç përcaktohet në pikën 2.3.1 të “Kapaciteteve Teknike” të DST.
- Nuk është paraqitur asnjë dokument për të provuar se operatori ekonomik është i pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive NP 1 – C; NP 2 - A; NP 4 - E; NP 7 - F; NP 12 - E; NS 9 - D; NS - 14 A; NS 16 - D; NS 18 – D, siç përcaktohet në pikën 2.3.2 të “Kapaciteteve Teknike” të DST.
- Nuk është paraqitur asnjë dokument për të provuar se operatori ekonomik ka në dispozicion stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit siç përcaktohet në pikën 2.3.4 të “Kapaciteteve Teknike” të DST.
- Nuk është paraqitur asnjë dokument për të provuar se operatori ekonomik ka apo mund t'i vihen në dispozicion1(një) nyje thyerje materiale inerte, 1 (një) fabrikë asfalti, 1 (një) fabrike betoni dhe 1 (një) fabrikë bitumi, të cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisorekodi III.1.B. Në rastin kur ka një kontratë qiraje/furnizimi me prodhuesin, bashkë me lejen mjedisore të prodhuesit, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e vlefshme, siç përcaktohet në pikën 2.3.6.3 të “Kapaciteteve Teknike” të DST.
- Nuk është paraqitur asnjë dokument për të provuar se operatori ekonomik garanton furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit, siç përcaktohet në pikën 2.3.7 të “Kapaciteteve Teknike” të DST.
- Nuk është paraqitur asnjë dokument për të provuar se operatori ekonomik është i pajisur me licencat/lejet të lëshuara nga QKL me kod III.2.B (Grumbullim dhe transportim të mbetjeve inerte), III.2.A (1+2) (Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis) dhe III.1.A (Pëlqim mjedisor për ndërtim kompleks banimi dhe shërbimi), siç përcaktohet në pikën 2.3.8 të “Kapaciteteve Teknike” të DST.

K.V.O. e cilëson ofertën e këtij operatori të refuzuar.

2. Operatori ekonomik B93 II shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotëson këto kritere:

- Nuk është paraqitur asnjë dokument për të provuar se operatori ekonomik i plotëson kërkesat e parashikuara në DST për kapacitetin ekonomiko-financiar dhe kapacitetin Teknik.

K.V.O. e cilëson ofertën e këtij operatori të refuzuar.

\* \* \* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE G.P.G Company shpk dhe Shëndelli shpk, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 658,284,768 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë milion e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kavajë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të zbatohen dispozitat që parashikohen në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08.04.2020

Ankesa: Nuk ka patur

Kryetari  
**Redjan KRALI**